

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**

**Formulari i njoftimit të fituesit**

**EUROTEOREMA PEQIN SHPK**

Adresa: rr. Kaastriotet, Nr. 25, Fushe Mezes, Kashar

**TIRANE**

Procedura e prokurimit: Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore Nyja Milot"

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-69729-05-18-2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

1.Fondi limit 1,314,486,342 (nje miliarde e treqind e katrembedhete milione e katerqind e tetedhete e gjashte mije e treqind e dyzet e dy) leke pa tvsh. Fondi i akorduar për vitin 2018 është 316.000.000 lekë Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2019, 2020.

2.Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit

3.Objekti i kontratës /marrëveshjes kuadër: Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore Nyja Milot. Punimet konsistojnë në:

A - Përfundimin e punimeve për vënien në shfrytëzim të Nyjes së Milotit, konform preventivit dhe vizatimeve të miratuara në Këshillin Teknik të mësipërm – për objektin “Ndërtim nyja lidhëse e rrugës Milot – Lezhë – Rrëshen – Thumanë” dhe

B – Kryerjen e volumeve të punës sipas projekt – preventivit të zbatimit të Rrugëve Dytësore, punimet e të cilit janë të lidhura domosdoshmërisht me vënien në shfrytëzim të Nyjes së Milotit.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

çmimi më i ulët X

oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- |   |                     |                  |                                             |
|---|---------------------|------------------|---------------------------------------------|
| 1 | ANK shpk            | NUIS: J9240801N  | oferta ekonomike 1.296.680.414 leke pa TVSH |
| 2 | Albavia shpk        | NUIS: J8152701Q  | oferta ekonomike 1.299.909.643 leke pa TVSH |
| 3 | Euroteorema Peqin   | NUIS: J61905050N | oferta ekonomike 1.290.516.400 leke pa TVSH |
| 4 | Varaku E shpk       | S KA OFERTE      |                                             |
| 5 | Vellezrit Hysa shpk | S KA OFERTE      |                                             |

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1.Albavia shpk NUIS: J8152701Q

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Nuk ploteson kriteret e veçanta të kualifikimit / kapaciteti teknik pika 2.3.1 “pune të ngjashme” pasi kontrata me objekt “Rikonstruksion i rruges Ura vajguore – Pashalli Bistrovic” dhe është perfunduar në 2014, si pasojë ploteson kushtin të realizuar me sukses gjatë “tri viteve të fundit”.

Per pune të ngjashme “Rikonstruksion i segmenteve blloku 11,2 ha-0.276 km; rruga pas stadiumit 0.265 km; Qarku Lezhë” me vlerë 280 538 092 leke, operatori ekonomik Albavia shpk, ka marrë persipër të kryejë 60 % të vlerës së kontratës dhe Gjiguria 40%. Kjo përqindje e realizuar është në vlerën 168 322 855.2 leke < 50% të fondit limit. Në DST kerkohet që operatori ekonomik duhet të ketë realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50 % e fondit limit që është realizuar me sukses gjatë tre viteve të fundit.

Nuk ploteson kriteret e veçanta të kualifikimit/ kapaciteti teknik pika 2.3.2 pasi numri mesatar i punonjesve për periudhën (prill 2015 – mars 2018) është kërkuar jo më pak se 150 punonjes. Vertetimi për numrin e punonjesve dhe listat e paraqitura nga operatori ekonomik është me i vogël se 150 (ka një numër mesatar të punësimit me 108 punonjes për periudhën e kërkuar).

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik Euroteorema Peqin shpk, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 1.290.516.400 (*njemiliarde e dyqind e nentëdhjetë milione e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind*) leke, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Rrugor Shqiptar, Adresa; Rruga “Sami Frashëri nr.33”, Tiranë, Tel/Fax +355 4 2234789 / +355 4 2223600, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 1.296.680.414 leke pa TVSH, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.06.2018.

Ankesa: Nuk ka